



Në bazë të autorizimeve të përcaktuara me nenin 63 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 6 paragrafi 1 germa c) dhe në zbatim të nenit 11 të Rregullës nr.01/2013, Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve** me datë 25 shkurt 2021 merr këtë:

V E N D I M

për pezullimin e partisë politike Napredna Snaga Kosova nga regjistri i partive

- I. Miratohet rekomandimi i Zyrës për pezullim të Partisë Politike “Napredna Snaga Kosova-NSK”, për mosdorëzimin e të dhënave të ndryshuara vjetore në pajtim me nenin 11 të Rregullës 01/2013 Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike.
- II. Në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 germa cc) të Rregullës 01/2013, partia politike, “Napredna Snaga Kosova-NSK”, pas marrjes së Vendimit për pezullim ka afat të shtuar prej njëzet (20) ditësh për të dorëzuar të dhënat e ndryshuara vjetore.
- III. Obligohet Zyra që ta njoftoj përfaqësuesin e Partisë Politike “Napredna Snaga Kosova-NSK”, për marrjen e këtij Vendimi.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi me datën e nënshkrimit.

Arsyetim

Partia politike, “Napredna Snaga Kosova” me akronimin NSK e regjistruar më 10 nëntor 2016, nuk ka përmbushur obligimet që dalin nga neni 11 të Rregullës 01/2013 Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, respektivisht nuk i ka dorëzuar përditësimet (azhurnimet vjetore) deri më 31 janar 2021 edhe pse zyrtari kontaktues i NSK, ka pranuar nga ZRPPC njoftimin për këtë detyrim ligjor për dorëzim të Formularit të Azhurnimeve Vjetore të Partisë Politike.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Valdete Daka, Kryetare

Këshillë juridike: Partia Politike, “Napredna Snaga Kosova” me akronimin NSK, ka të drejtë ankese në Panelin Zgjedhore për Ankesa dhe Parashpresa – PZAP, brenda 24 orëve nga pranimi i këtij vendimi të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për pezullim nga regjistri i partive .